

Termat e References

**Rishikim i projektit ekzistues për rikonstrukcionin e segmentit rrugor Perlat –
Kurbnesh – Krej Lurë dhe Projektim për rikonstrukcionin e segmentit rrugor
Krej Lurë – Fushë Lurë”**

”

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

01.1. Bashkia përfituese

Bashkia Lezhe/Diber

01.2. Autoriteti kontraktues

Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) është autoriteti kontraktues për këtë kontratë. FSHZH është një agjenci, misioni i së cilës është promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror, nivel të balancuar dhe kohezion rajonal dhe lokal. FSHZH u krijua në fillim të vitit 1993, në bazë të marrëveshjes midis Qeverisë Shqiptare dhe Bankës Botërore. Kuadri ligjor për krijimin dhe funksionimin e FSHZH-së përbëhet nga Ligji nr.10130, datë 11.5.2009, "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit". FSHZH zbaton projekte të financuara nga Donatorët Ndërkombëtarë dhe Qeveria shqiptare me fushën e zhvillimit lokal dhe rajonal.

01.3. Vendodhja gjeografike dhe gjendja ekzistuese e rruges

Aksi rrugor Perlat i Eperm– Kurbnesh- Krej Lure-Fushe Lure fillon ne Pg 0+000 (Kryqezim Perlat-Urake) vazhdon ne Pg 32+200 Krej Lure (Kisha e Fshatit) dhe perfundon ne Pg 39+500. Me gjatesi totale L=39,5Km.

Rruga eshte e pa asfaltuar, me shtresa material i thyer guror dhe kalldremi. Gjeresia e trupit te rruges varion nga 3.5-5.0 m. Rruga zhvillohet ne nje terren kodrinor-malor me pjerresi relativisht te medha qe variojne nga 3-12% dhe zhvillohet ne formacione te forta dhe te qendrueshme shkembore. Segmenti rrugor shoqerohet gjate gjithë gjatesise se tij me vepra arti te vogla dhe mesatare (tombino, mure, ura, etj.), me demtime pjesore. (Shih Fig. 1)




Fig. 1 Gjurma e aksit rrugor “Perlat i Eperm– Kurbnesh- Krej Lure-Fushe Lure”

Ne menyre kronologjike segmenti rrugor pershkon zonat e banuara si me poshte:

Ky aks fillon ne perlatin e Eperm kalon ne fshatin Ndreaj ne anen jugore te tij ne Km 3+700. Aktivitetet kryesore ekonomike te zones jane bujqesia dhe blegtoria. Ne kete segmentin, rruga zhvillohet pergjithesisht ne terren kodrinor me pjerresi variable rreth 4–8%.

Segmenti Ndreaj-K/Lekunde-Kurbnesh, zhvillohet ne nje terren kodrinor-malor me pjerresi qe variojne nga 5-10% ne formacione te forta dhe te qendrueshme shkembore. Ne Km 11+800 ndodhet Kryqezimi me rrugen e fshatit Lekunde. Ne kete kryqezim ndahet Njesite Administrative Kthelle me Selite, ne vazhdim rruga vazhdon ne drejtim te Kurbneshit segment fillon ne kryqezimin e rruges qe te con te ish miniera e bakrit dhe perfundon ne fundin e zones te banuar ne Kurbnesh.

Segmenti dalja e Kurbneshit –Merkurth kalon ne krahun e majt te perroit te zallit te Murkurthit KM 27+500, zhvillohet ne nje terren malor me pjerresi te medha qe variojne nga 5-12% ne formacione te forta dhe te qendrueshme shkembore.

Segmenti Merkurth-Krej Lure-Fushe Lure kalon nga fshati Merkurth i cili shtrihet deri ne Km 28+600, ne Km 29+100 ndodhet kryqezimi i fshatit Kumbull (ne qafen e Merkurthit), zhvillohet ne nje terren kodrinor-malor me pjerresi te medha qe variojne nga 8-12% ne formacione te forta dhe te qendrueshme shkembore. Kjo pike eshte dhe kufiri ndares midis qarkut te Lezhes dhe Qarkut te Dibres.

Segmenti K/Kumbull-Krej Lure –Fushe Lure, zhvillohet ne nje terren malor me pjerresi qe variojne nga 3-5% ne formacione te forta dhe te qendrueshme shkembore. Segmenti perfundon ne fshatin Fushe Lure (Ura e Tollajve).

Ne te gjithë gjatesine , aksi rrugor Perlat i Eperm– Kurbnesh- Krej Lure-Fushe Lure, ka ura dhe vepra te vogla arti (tombino, kanale anesore, mure guri dhe betoni) ne gjendje pjesisht te mire. Pergjate gjithë aksit rrugor ndodhen tombino ekzistuese rrethore me diameter Ø300-Ø1000 mm. Pjesa me e madhe e tyre eshte jashte funksionit, per shkaqe te ndryshme si bllokime, demtime si pasoje e gryerjeve, armature e zbuluar dhe e koroduar, etj.

Foto te rruges i gjeni ne (Fig. 2-3,4-5, 6-7, 8-9 dhe 10-11) :



Fig. 2 -3 Pamje Perlat (Kryqezim Urake)-Ndreaj



Fig. 4-5 Pamje nga segmenti Ndreaj-K/Lekunde



Fig. 6-7 Pamje nga segmenti Lekunde- Kurbnesh



Fig. 8-9 Pamje nga segmenti Kryqezim Kumbull-Krej Lure



Fig. 10 -11 Pamje nga segmenti Krej Lure-Fushe Lure

02

PËRSHKRIMI I PUNËS

02.1. Objektivi

Objektivi kryesor i projektit: “Rikonstruksioni i rruges Perlati Eperm – Kurbnesh- Fushe Lure” është përmirësimi i aksesit të turistëve dhe vizitorëve drejt potencialeve turistike natyrore e kulturore të zonës, duke ofruar një mundësi për zhvillimin ekonomik të komuniteteve lokale dhe të rajonit. Projekti i rikonstruksionit do të synojë të përmirësojë qarkullimin dhe sigurinë rrugore duke ruajtur gjurmën ekzistuese të rrugës.

02.2. Qëllimi

Qëllimi i këtij projekti është përgatitja e projektit të zbatimit për këtë segment rrugor.

02.3. Shërbimet e kërkuara

Shërbimet e kërkuara do të jenë në përputhje me **VKM 354, datë 11.05.2016**.

Perditesimi i projektit të zbatimit dhe preventivit perfundimtar për segmentin Perlat i Eperm – Kurbnesh- Krej Lure si dhe hartimi i projektit të zbatimit për segmentin Krej i Lures-Fushe Lure duke ruajtur gjurmen ekzistuese dhe, se bashku me dokumentacionet mbështetese, në përputhje me kërkesat e detyrës së projektimit.

02.3.1. Ndërhyrjet e propozuara

Ndërhyrjet e propozuara në projekt të jenë:

- Ndertimi i shtresave asfaltike të rruges.
- Ndertimi i nenshtresave.
- Zgjidhjen e drenazhimit të rruges.
- Nderimi i mureve mbajtese dhe pritese.
- Ndertimi i tombinove dhe veprave të artit .
- Punime elektrike, ndriçim dhe rrjetin e fibrave optike.
- Sinjalistiken vertikale dhe horizontale.
- Masat mbrojtese inxhinjrike, aty ku është e nevojshme.
- Etj.

02.3.2. Kostot e projektimit

Tabela e vlerësimit të kostos:

No.	Emri i Zonës/Projekti	Vlerësimi i kostos së investimit, në Lekë (pa TVSH)	Kategoria e Tarifave të Shërbimit të projektimit
1	Rikonstruksioni i rruges Perlati Eperm – Kurbnesh- Krej Lure	1,813,752,344	Strukturat Transporti, Grupi tarifar III
2	Rikonstruksioni i rruges Krej Lure- Fushe Lure	501,041,667	Strukturat Transporti, Grupi tarifar III

02.3.3. Elementët e projektit

1. **Per rikonstruksionin e rruges Perlati Eperm – Kurbnesh- Krej Lure**, shërbimet e kërkuara do të jenë përgatitja e dorëzimi i fazave V- VI të projektit (faza V –VI do të jete 30 % e vleres së plote të këtyre fazave), rishikimi i studimeve topografike dhe gjeologjike do të jete 30% e vleres së plote për këto studime. VNM do të jete në vlerën e plote për të gjithë gjatësinë e rruges Perlati i Eperm- Fushe Lure. Të gjitha fazat do të jete në përputhje me VKM Nr. 354, datë 11.05.2016

Elementet e projektit janë më poshtë:

- Projekti i detajuar i zbatimit (perditesim dhe firmosje elektronike);
- Preventivi perfundimtar (i rishikuar me cmimet e vkm se cmimeve ne fuqi)
- Raporti për vlerësimin e ndikimit në mjedis duhet të jetë në përputhje me Ligjin Nr.10440, datë 07.07.2011, VKM 686 date 29.07.2015 dhe akteve nënligjore përkatëse (për perditesim sipas legjislacionit ne fuqi);
- Raporti i shpronësimeve ne se ka.
- Raportin e Analizës Ekonomike.

2. **Per rikonstruksionin e rruges Perlati Krej Lure – Fushe Lure**, shërbimet e kërkuara do të jenë përgatitja e dorëzimi i fazave I - VI të projektit, në përputhje me VKM Nr. 354, datë 11.05.2016

Elementet e projektit janë më poshtë:

- Analiza e detyres se projektimit/termat e references dhe percaktimi i baze se projektit
- Projekt idea paraprake
- Projekt idea perfundimtare
- Projekti për miratimin e leje se ndërtimit;
- Projekti i detajuar i zbatimit;
- Preventivi perfundimtar
- Raporti për vlerësimin e ndikimit në mjedis duhet të jetë në përputhje me Ligjin Nr.10440, datë 07.07.2011, VKM 686 date 29.07.2015 dhe akteve nënligjore përkatëse (për rinovim leje);
- Raporti i shpronësimeve ne se ka.
- Raportin e Analizës Ekonomike.

02.4. Elementët e produkteve të projektimit

02.4.1 Per segmentin rrugor Perlat i Siperim – Kurbnesh - Krej Lure, konsulenti duhet te pergatise:

Faza V+VI. Projekti i zbatimit dhe preventivi perfundimtar

Pas detyrës së miratuar nga Autoriteti Kontraktues dhe përfituesve, konsulenti do të vazhdojë me përgatitjen e projektit të detajuar të zbatimit (te perditesuar).

Projekti i zbatimit duhet të përmbajë:

- Vizatimet
- Raport teknik
- Preventiv (me dhe pa çmime)
- Specifikime teknike
- Grafik punimesh
- Plan shpronësimesh (nëse ka)
- Raporti i VNM- së dhe PMMS (Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social).

Vizatimet

Vizatimet (**te perditesuar**)duhet të përmbajnë minimalisht fletët e mëposhtme:

- Horografia
- Planimetrinë e rrugës ekzistuese
- Harta e Rilevimit topografik
- Planimetrinë e rruges se rikonstruktuar
- Profilin gjatësor
- Profilet TIP e detaje
- Profilet tërthore për çdo piketë, volumet e gjermim – mbushjeve.
- Veprat e artit dhe detaje, etj ne se ka.
- Projektin e sinjalistikës.
- Projektin elektrik, ndriçimit dhe rrjetit të fibrave optike.
- Gjelberimi.
- Etj.

Raport teknik

Në raportin teknik (**te perdituesar**) përfshihet gjithë informacioni në lidhje me projektin. Në të përshkruhet analiza e kryer nga projektuesit për gjendjen dhe projektimin e saktë të propozuar, jepen të dhëna të sakta, bazuar në teste për gjendjen egzistuese, jepen llogaritjet e trafikut, llogaritjet e shtresave, llogaritja e veprave te artit, masat inxhinierike që janë parashikuar të merren, modeli kompjuterik i llogaritjeve, volumet, etj Në raportin teknik do të përfshihen raporti përfundimtar i studimit topografik, studimit gjeologjik, i studimit gjeoteknik dhe investigimit të materialeve, raporti hidrologjik e hidraulik, etj.

Specifikime Teknike

Projektuesi duhet të përgatisë specifikimet teknike për secilin nga materialet që do të përdoren. Për secilin zë të përfshirë në preventiv duhet të jepet:

- Përshkrimi i detajuar i zërit të punës, materialet që do të përdoren, cilësia e tyre, etj
- Metoda e kryerjes së punimeve
- Cilesia e kërkuar e punimeve
- Formatet e lejuara
- Ngjyra e rekomanduar
- Njësia e matjes
- Etj.

Konsulentin duhet të ketë parasysh se për të gjitha specifikimet e materialeve nuk duhet të përcaktojë emrin e kompanisë që i prodhon.

Preventivi (i perdituesar)

- Preventivi për zbatimin e projektit (bazuar në VKM No.2. date 08.05.2003. “Mbi klasifikimin dhe strukturën e koston në ndërtim”);
- Analizë teknike e çmimeve për të gjitha punimet e vlerësuara në preventive të bazuar në VKM nr 627, datë 15.7.2015. "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizës teknike të tyre".
- Zërat e punimeve që nuk janë të përfshira në manualin teknik të çmimeve në fuqi, duhet të shoqërohen me zbërthimin e çmimit dhe t'i bashkëngjiten vlerësimit.
- Vlera e preventivit përfundimtar nuk duhet të tejkalojë vlerën e përlllogaritur të investimit (më lartë: Tabela e vlerësimit të koston).

- Preventivi të shoqërohet me tabelat e volumeve.

Grafiku i punimeve

Grafiku i punimeve (i perditesuar) të hartohet bazuar në zërat e punës dhe teknologjinë e punimeve të shprehura në Preventiv.

Plani shpronësimesh (i perditesuar)

Në planin e shpronësimeve të përfshihet një planimetri me zonat kadastrale, si dhe një listë të konfirmuar nga ZVRPP me listën e pronarëve dhe sipërfaqen përkatëse (në se ka). Përllogaritjen e vlerës së shpronësimit sipas VKM së shpronësimeve në fuqi.

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe PMMS të përgatitet sipas legjislacionit në fuqi dhe ESP (Environmental and Social Policy) bazuar në kërkesat për performancën mjedisore të miratuar nga bordi i drejtoreve të BERZH me datë 25 prill 2019, për projektet që vazhdojnë pas datës 1 janar 2020 VNM duhet të përgatiten nga një ekspert i licensuar për vlerësimin e ndikimit në mjedis (përfshirë edhe licencën e marrë nga QKL-ja dhe ekstraktin nga QKB-ja).

Raport teknik për heqje nga fondi pyjor

Për çdo rast nëse del e nevojshme duhet të hartohet Raporti teknik sipas VKM 1353 datë 10.10.2008 (azhurnuar me VKM 434 datë 08.06.2016) “Për Rregullat Për paraqitjen E Kërkesës, Mbajtjen Dhe Plotësimin E Dokumentacionit Teknik, Kriteret Dhe Proçedurat E Zvogëlimit Të Sipërfaqes Dhe Të Vëllimit Të Fondit Pyjor”, i shoqëruar me pas me Projektin e rehabilitimit nëse do të ketë nevojë.

Raporti i Analizës Ekonomike

Konsulenti duhet gjithashtu të vlerësojë fizibilitetin ekonomik dhe justifikimin e projekt zbatimit të propozuar duke përdorur softuerin HDM-4, dhe më pas të përgatisë dhe dorëzojë Raportin e Analizës Ekonomike. Konsulenti duhet të ofrojë Klientit të gjitha dokumentet e krijuara me softuerin HDM-4 (object.dat dhe object.idx) që Konsulenti ka krijuar për qëllime të analizave ekonomike.

Plan Organizimi i punimeve

Plani i organizimit të punimeve në kantier sipas legjislacionit në fuqi.

02.4.2 Për segmentin rrugor Krej Lurë - Fushë Lurë konsulenti duhet të përgatisë:

Faza I. Analiza e detyrës së projektimit/termave të referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit

- Mbledhja e të dhënave të gjëndjes ekzistuese
- Analizimi i gjëndjes ekzistuese dhe identifikimi i problematikave që ndikojnë në hartimin e projektit
- Planifikimi i punës dhe burimeve për realizimin cilësor të projektit

Faza II. Projekt idea paraprake

Projekt ideja paraprake duhet të përfshijë minimalisht:

- Studimin e zgjidhjes dhe paraqitjen grafike
- Llogaritja paraprake e kostos
- Raportin paraprak

Faza III. Projektit idea përfundimtare

Projekt idea përfundimtare duhet të përfshijë minimalisht:

- Vizatimet e zgjidhjes përfundimtare sipas standardeve të projektimit
- Raportin teknik, ku përfshihen llogaritjet, studimet, etj
- Preventivin;
- Të bëjë një prezantim të projektit përpara Përfituesit dhe Autoritetit Kontraktor;

Faza IV. Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit

- Përpunimi e dorëzimi i dokumentave për procedurat e nevojshme juridike e ligjore të miratimit të lejes së ndërtimit.

Faza V+VI. Projekti i zbatimit dhe preventivi përfundimtar

Projekti i zbatimit duhet të përmbajë:

- Vizatimet
- Raport teknik
- Preventiv (me dhe pa çmime)
- Specifikime teknike
- Grafik punimesh
- Plan shpronësimesh (nëse ka)
- Raporti i VNM- së dhe PMMS (Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social).

Vizatimet

Vizatimet duhet të përmbajnë minimalisht fletët e mëposhtme:

- Horografia
- Planimetrinë e rrugës ekzistuese
- Harta e Rilevimit topografik
- Planimetrinë e rruges së rikonstruktuar
- Profilin gjatësor
- Profilet TIP e detaje
- Profilet tërthore për çdo piketë, volumet e germim - mbushjeve
- Veprat e artit dhe detaje, etj nëse ka.
- Projektin e sinjalistikës horizontale dhe vertikale.
- Projektin elektrik, ndriçimit dhe rrjetit të fibrave optike. Detaje përkatëse;
- Gjelberimi.
- Projektin e KUB, KUZ,
- Detaje të shtresave dhe detaje të ndryshme për pasurim sa më të plotë të projektit të zbatimit.

Raport teknik

Në raportin teknik përfshihet gjithë informacioni në lidhje me projektin. Në të përshkruhet analiza e kryer nga projektuesit për gjendjen dhe projektimin e saktë të propozuar, jepen të dhëna të sakta, bazuar në teste për gjendjen ekzistuese, jepen llogaritjet e trafikut, llogaritjet e shtresave, llogaritja e

veprave të artit, masat inxhinierike që janë parashikuar të merren, modeli kompjuterik i llogaritjeve, volumet, etj Në raportin teknik do të përfshihen raporti përfundimtar i studimit topografik, studimit gjeologjik, i studimit gjeoteknik dhe investigimit të materialeve, raporti hidrologjik e hidraulik, etj.

Preventivi

- Preventivi për zbatimin e projektit (bazuar në VKM No.2. date 08.05.2003. “Mbi klasifikimin dhe strukturën e kostos në ndërtim”);
- Analizë teknike e çmimeve për të gjitha punimet e vlerësuara në preventivë të bazuar në VKM nr 627, datë 15.7.2015. "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizës teknike të tyre".
- Zërat e punimeve që nuk janë të përfshira në manualin teknik të çmimeve në fuqi, duhet të shoqërohen me zbërthimin e çmimit (analizën përkatëse) dhe t'i bashkëngjiten vlerësimit.
- Vlera e preventivit përfundimtar nuk duhet të tejkalojë vlerën e përlogaritur të investimit (më lartë: Tabela e vlerësimit të kostos).
- Preventivi të shoqërohet me tabelat e volumeve.

Specifikime Teknike

Projektuesi duhet të përgatisë specifikimet teknike për secilin nga materialet që do të përdoren. Për secilin zë të përfshirë në preventiv duhet të jepet:

- Përshkrimi i detajuar i zërit të punës, materialet që do të përdoren, cilësia e tyre, etj
- Metoda e kryerjes së punimeve
- Cilesia e kërkuar e punimeve
- Formatet e lejuara
- Ngjyra e rekomanduar
- Njësia e matjes
- Etj

Konsulenti duhet të ketë parasysh gjithashtu se për të gjitha specifikimet e materialeve nuk duhet të përcaktojë emrin e kompanisë që i prodhon.

Grafiku i punimeve,

Grafiku i punimeve të hartohet bazuar në zërat e punës dhe teknologjinë e punimeve të shprehura në Preventiv.

Plani shpronësimesh

Në planin e shpronësimeve të përfshihet një planimetri me zonat kadastrale, si dhe një listë të konfirmuar nga ASHK me listën e pronarëve dhe sipërfaqen përkatëse (ne se ka). Përlogaritjen e vlerës së shpronësimit sipas VKM së shpronësimeve në fuqi.

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe PMMS të përgatitet sipas legjislacionit në fuqi dhe ESP (Environmental and Social Policy) bazuar në kërkesat për performancën mjedisore të miratuar nga bordi i drejtoreve të BERZH me datë 25 prill 2019, për projektet që vazhdojnë pas datës 1 janar

2020 VNM duhet të përgatiten nga një ekspert i licensuar për vlerësimin e ndikimit në mjedis (përfshirë edhe licencën e marrë nga QKL-ja dhe ekstraktin nga QKB-ja).

Raport teknik për heqje nga fondi pyjor

Për çdo rast nese del e nevojshme duhet të hartohet Raporti teknik sipas VKM 1353 date 10.10.2008 (azhurnuar me VKM 434 date 08.06.2016) “Për Rregullat Për paraqitjen E Kërkesës, Mbajtjen Dhe Plotësimin E Dokumentacionit Teknik, Kriteret Dhe Proçedurat E Zvogëlimit Të Sipërfaqes Dhe Të Vëllimit Të Fondit Pyjor”, i shoqëruar me pas me Projektin e rehabilitimit nese do të kete nevojë.

Raporti i Analizës Ekonomike

Konsulenti duhet gjithashtu të vlerësojë fizibilitetin ekonomik dhe justifikimin e projekt zbatimit të propozuar duke përdorur softuerin HDM-4, dhe më pas të përgatisë dhe dorëzojë Raportin e Analizës Ekonomike. Konsulenti duhet ti ofrojë Klientit të gjitha dokumentet e krijuara me softuerin HDM-4 (object.dat dhe object.idx) që Konsulenti ka krijuar për qëllime të analizave ekonomike.

Plan Organizimi i punimeve

Plani i organizimit të punimeve në kantier sipas legjislacionit në fuqi.

02.4.3. Standartet e projektimit

Projektuesi është përgjegjës të sigurojë saktësinë dhe pajtueshmërinë me të gjitha standardet dhe legjislacionin përkatës.

Projekti duhet të zbatohet të gjitha normat e miratuara për personat me aftësi të kufizuara (të verbër, etj.) Projekti duhet të sigurojë infrastrukturën e nevojshme për këtë kategori.

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe inkurajohet për përdorimin e programeve të reja.

02.4.4. Dokumentacioni në dispozicion të Konsulentit

Konsulentit do ti vihet në dispozicion nga FSHZH-ja, projekti ekzistues i zbatimit (*viti 2012*) të segmentit rrugor “Perlat i Eperm-Kurbnesh-Krej i Lures” së bashku me dokumentacionin shoqëruar.

03

KOHEZGJATJA DHE DOREZIMI I PRODUKTEVE

03.1. Kohezgjatja,

Kohëzgjatja e shërbimeve do të jetë 3 muaj nga data e fillimit.

03.2. Dorëzim dokumentacioni teknik dhe afatet

Dokumentat që duhen dorëzuar e afatet janë:

	Numri i kopjeve	
--	------------------------	--

Dokumentacioni	Kopje te printuara	CD	Afati
<i>Per segmentin Perlat i Eperm – Kurbnesh – Krej Lure</i>			
Rishikimi i projekti i zbatimit (se bashku me dokumentacionin shoqerues: raport, specifikime teknike, preventivi me cmime e pa cmime, grafiku i punimeve)	1(nje) në anglisht dhe 4 (kater) në shqip	2	1 muaj pas lidhjes se kontrates*
<i>Per segmentin Krej Lure-Fushe Lure</i>			
Per segmentin Analiza e gjendjes ekzistuese dhe Projekt-idea paraprake (se bashku me dokumentacionin shoqerues)	1(nje) në anglisht dhe 1 (nje) në shqip	1	1 muaj pas lidhjes se kontrates
Projekt-idea perfundimtare (se bashku me dokumentacionin shoqerues)	1(nje) në anglisht dhe 1 (nje) në shqip	1	2 muaj mbas lidhjes se kontrates
Projekti i zbatimit (se bashku me dokumentacionin shoqerues: raport, specifikime teknike, preventivi me cmime e pa cmime, grafiku i punimeve)	1(nje) në anglisht dhe 4 (kater) në shqip	2	3 muaj mbas lidhje se kontrates
VNM (per te dy segmente)	1(nje) në anglisht dhe 4 (kater) në shqip		3 muaj pas lidhjes se kontrates*
Planet e shpronesimit (per te dy segmente)	1(nje) në anglisht dhe 4 (kater) në shqip		3 muaj pas lidhjes se kontrates*

Ne afate perfshihen dhe koha 1 javore per komentet e klientit dhe 1 jave per korrigjimet nga konsulenti.

Vizatimet dhe raportet duhet të shtypen në 5 (pese) kopje origjinale, 1 (nje) kopje në gjuhën angleze dhe 4(kater) në shqip, 1 (një) CD me të gjitha materialet në formatet e editueshme përkatëse (acad, word, exel, avi, etj.) etj.) dhe 1 (një) CD në PDF te firmosur me vule elektronike me te gjithë dokumentacionin e nevojshem, sipas ligjeve ne fuqi per aplikim per leje ndertimi.

Dorëzimi i dokumentacionit do të bëhet në rrugë zyrtare shoqëruar me fletë inventari. Të gjitha dokumentat e printuara duhet të jenë të firmosura e vulosura në origjinal nga të gjithë projektuesit.